



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
MINISTRI

Nr. 3589/ Prot.  
4

Tiranë, më 28 /04/2014

UDHËZIM

PËR KONTABILIZIMIN DHE RAPORTIMIN E TË ARDHURAVE DOGANORE

Nr. 11/ datë 28.4 2014  
1

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 216 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, nenit 6 të Ligjit Nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe në vijim të Udhëzimit Nr.29, datë 24.12.2013 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2013",

**Udhëzohet:**

***Kontabilizimi i të ardhurave doganore***

1. Arkëtimet që rezultojnë nga derdhjet paraprake të mjeteve monetare / kreditimet e subjekteve tatimpaguese në llogarinë bankare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) konsiderohen fillimisht si parapagesa për sistemin doganor dhe duhet të regjistrohen si të tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në debi të llogarisë bankare 520 "Disponibilitete në Thesar" dhe në kredi të llogarisë kontabël 4701 "Llogari në pritje -të ardhura doganore për tu marrë".
2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kontabilizon si të ardhura doganore vetëm shumat e mjeteve monetare që i korrespondojnë deklaratave doganore të subjekteve duke kryer veprimin kontabël për cdo transaksion në debi të llogarisë 4701 "Llogari në pritje -të ardhura doganore për tu marrë" dhe në kredi të llogarive respektive 70 "Tatime dhe kontribute të detyrueshme" në nivel shtatëshifror sipas natyrës së të ardhurës.
3. Teprica e llogarisë kontabël 4701 "Llogari në pritje -të ardhura doganore për tu marrë" në çdo moment pasqyron shumën e mjeteve monetare të parapaguara nga subjektet tatimpaguese për shlyerjen e detyrimeve të ardhshme dhe si të tilla paraqiten, për levizjet gjatë periudhave kontabel, në pjesën e financimit të defiçitit në pasqyrat e konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme.

#### **Raportimi financiar për muajin Dhjetor 2013**

4. Shuma e të ardhurave doganore të akumuluar deri në fund të muajit Dhjetor 2013, të regjistruara si të tilla në sistemin informatik financiar të qeverisë, do të korrigjohet në kontabilitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sipas shumës së deklaratave doganore të akumuluar deri në fund të muajit Dhjetor 2013. Diferencat që rezultojnë midis shumës së mjeteve monetare të arkëtuara në llogarinë bankare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave deri në fund të muajit Dhjetor 2013 dhe shumës së deklaratave doganore deri në fund të muajit Dhjetor 2013, konsiderohen parapagesa sipas pikës 1 të këtij udhëzimi. Kjo diferencë do të regjistrohet nga DPD në kredi të llogarisë 4701 "Llogari në pritje -të ardhura doganore për tu marrë" dhe të paraqitet si zë më vehte në raportimin financiar përfundimtar për vitin 2013, në degën e Thesarit Tiranë. Në raportin financiar të DPD për vitin 2013, shuma e zërit 4701 së bashku me shumën e korrigjuar e të ardhurave doganore (llogarite 70) të konstatuara për vitin 2013, duhet të jetë e barabartë me shumën e mjeteve monetare të arkëtuara në llogarinë bankare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave gjatë vitit 2013, e njëjtte me shifrën që rezulton edhe në sistemin informatik financiar të qeverisë për të njëjtën periudhë kohore.

#### **Raportimi financiar periodik duke filluar nga data 1 Janar 2014**

5. Duke filluar nga data 1 Janar 2014 e në vazhdim, çdo fillim muaji Drejtoria e Përgjithshme e Doganave raporton në degën e Thesarit Tiranë (i) të ardhurat doganore të arkëtuara gjatë muajit sipas deklaratave doganore në zërat e llogarive 70 "Tatime dhe Kontribute të detyrueshme" si dhe (ii) lëvizjet mujore të llogarisë kontabël 4701 "Llogari në pritje -të ardhura doganore për tu marrë". Shuma e tyre duhet të jetë e barabartë me mjetet monetare të arkëtuara në llogarinë bankare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave gjatë muajit, e njëjtte me shifrën që rezulton edhe në sistemin informatik financiar të qeverisë për të njëjtën periudhë kohore.
6. Udhëzimi Nr. 11, datë 18.04.2014 "Për kontabilizimin dhe raportimin e të ardhurave doganore" shfuqizohet.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Financiare për zbatimin e këtij udhëzimi.
8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

